



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
INSTITUTI I HISTORISË - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU

Njësia Org. Org. Unit. Nr. I. prot. Prot. N. 01/38/24
Org. Jed. I.H Br. Prot.
Nr. i Faqeve No. Pages Data: 16/05/2024
Br. Stranica 4 Datum:

PRISHTINË - A



Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë

Instituti për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore

të Shqiptarëve - Shkup

Prishtinë/Shkup, më 16/05/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

INSTITUTIT TË HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË

DHE

INSTITUTIT PËR TRASHËGIMI SHPIRTËRORE DHE
KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

Neni 1

Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë dhe Instituti për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, përfaqësuar nga drejtorët e instituteve.

Neni 2

Qëllimi dhe arsyetimi

Duke parë nevojën për bashkëpunim dhe mbështetje reciproke në fushat prioritare të dy instituteve dhe duke parë rendësin e historisë në përgjithësi e asaj kombëtare në veçanti dhe rolin mbrojtjes së trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore dhe, si dhe bashkëpunimin shkencor në këtë fushë, Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup u dakorduan për firmosjen e marrëveshjes së bashkëpunimit.

Neni 3

Objekti i marrëveshjes për bashkëpunim

1. Duke u nisur nga fakti se bashkëpunimi i ndërsjellë dhe reciprok midis dy instituteve paraqet prioritet të rëndësishëm në aktivitetet e tyre, të njëjtët vendosën se objekt i kësaj marrëveshje duhet të jenë elementët kyç:
 - 1.1. këmbimi i literaturës profesionale-shkencore;
 - 1.2. realizimi i projekteve hulumtuese-shkencore në fushën e historisë dhe trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore;
 - 1.3. këmbimi i kontakteve dhe bashkëpunimi në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar të dy instituteve, dhe forcimi i partneritetit me institucione tjera.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet Literatura profesionale

1. Dy institutet kanë nevojë për përforcimin e bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë në këmbimin e literaturës profesionale dhe revistave shkencore, që do të jenë me interes për punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit e dy instituteve. Për këtë qëllim, institutet u dakorduan që të zhvillojnë sistem me të cilin do të përforcohet bashkëpunimi dhe komunikimi midis bibliotekave të instituteve, që do të mundësojnë qasje pa pengesa në fondet bibliotekistë.
2. Palët pajtohen që të shkëmbejnë pa pengesë dhe falas materiale arkivore të instituteve dhe literaturë shkencore në interes të të dyja instituteve dhe studiuesve të tyre.
3. Palët pajtohen që të kenë pjesëmarrje të ndërsjellë në këshillat botuese dhe shkencore të revistave shkencore: Kosova, Studime albanologjike, Scupi dhe Ballkanologjia.

Neni 5

Projekte dhe hulumtime

1. Dy institutet kanë nevojë për bashkëpunim më të madh në projekte të përbashkëta për hulumtimin e fushave për të cilat ka interes reciprok, veçanërisht në fushat në të cilat do të hulumtohen pika të përbashkëta nga historia e Kosovës dhe historia e kaluar e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut.
2. Dy institutet u pajtuan që të formohen grupe që do të përgatisin elaborate për projekte të përbashkëta.

Neni 6

Aktivitetet e përbashkëta

1. Institutet në të ardhmen do të përgatisin, organizojnë dhe realizojnë aktivitete të përbashkëta të të dy instituteve.
2. Caktimi i një koordinatori përgjegjës nga secili institut për bashkërendimin e aktiviteteve kërkimore dhe shkencore.

Neni 7

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

1. Institutet dakordohen që:
 - 1.1. Të identifikojnë, punojnë dhe të ndihmohen reciprokisht në projekte hulumtuese që prekin tema rajonale dhe ndërkombëtare.
 - 1.2. të shkëmbejnë kontakte të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar.
 - 1.3. të organizojnë vizita studimore dhe vizita në institucione (institucione shkencore, arsimore, arkiva) të cilat do të ishin burim i hulumtimeve të përbashkëta.
 - 1.4. të marrin përgjegjësi individuale lidhur me shpenzimet financiare.

Neni 8

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhet përmes negociatave ndërmjet palëve.

Neni 9

Anulimi

1. Anulimi i kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet me vullnet të palëve, në rast se njëra prej tyre ka dështuar ta përmbushë atë ose kërkon anulimin e njëanshëm të saj.
2. Pala që dëshiron anulimin është e obliguar që të njoftojë palën tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.

Neni 10
Kohëzgjatja

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje është 4 (katër) vjet.
3. Kjo Marrëveshje është e hartuar në 4 (katër) kopje, nga 2 për secilën palë nënshkruese.

PALET NËNSHKRUESE

Për

Institutin e Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë

Për

**Instituti për Trashëgimi Shpirtërore
dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup**

Prof. Dr. Teuta SHALA-PELI

Drejtoreshë



Prof. Dr. Skender ASANI

Drejtor

